

Tiranë më 24.03.2021

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“SIRIO 2021” SH.P.K

HYRJE

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Sirio 2021” Sh.p.k themelohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi të parashikuara në Ligjin Nr 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar), Ligjin Nr 9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”, (i ndryshuar) dhe Ligjin Nr 9723, datë 03.05.2007. “Për qendrën kombëtare të regjistrimit”.

KREU 1

PJESA E PËRGJITHSHME

DATA E THEMELIMI, THEMELUESI DHE EMRI I SHOQËRISË

NENI 1

1.1 Sot, ditën e martë, më datë 24.03.2021 (dymije e njëzet e një), ne themeluesit:

1. **Z. Elvis GJONAJ**, atësia Mikel, lindur më 02.06.1988 ne Rrëshen dhe banues në Rrëshen, shtetas shqiptarë, i identifikuar nepermjet letërnjoftimit (ID) me Nr. 036280430 dhe me Nr. Personal. I80602052D, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;
 2. **Z. Afrim GJESTILA**, atësia Xhelal, lindur më 01.08.1974 ne Thumanë dhe banues në Thumanë, shtetas shqiptarë, i identifikuar nepermjet letërnjoftimit (ID) me Nr. 035940153 dhe me Nr. Personal. H40801014K, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;
 3. **Z. Besim SUKTHI**, atësia Bajram, lindur më 03.07.1985 ne Prezë dhe banues në Budull, Kruje, shtetas shqiptarë, i identifikuar nepermjet letërnjoftimit (ID) me Nr. 035948416 dhe me Nr. Personal. I50703061G, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;
- Ne personat e sipercituar deklarojme se kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

1.2 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar do të jetë “Sirio 2021” Sh.p.k.

OBJEKTI

NENI 2

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushat që vijojnë: Import dhe eksport, instalim, mirembajtje, tregti me pakice dhe shumice të paisjeve kompjuterike, kancelarike, telefonike, elektronike, mekanike, të telekomunikacionit, elektrike, hidraulike etj. Shërbime informatike, kancelarike dhe telefonike. Shpërndarje interneti. Krijim dhe mirembajtje faqesh interneti. Mirembajtje rrjeti dhe serverash. Krijim dhe shpërndarje programe kompjuterike. Konsulencë teknike dhe riparim pajisje kompjuterike dhe elektronike. Tregtim, import dhe eksport, instalim, mirembajtje dhe tregtim i sistemeve të telefonise, sistemeve të alarmit kundra vjedhjes, sistemeve të alarmit kundra zjarrit, sistemeve të kamerave të survejimit dhe vëzhgimit CCTV, sistemeve të akses-kontrollit, sistemeve të aparaturash mjekësore, sistemeve UPS, stabilizatore, gjeneratore, radio nderlidhje, sistemeve me fiber optike, etj. Nderitim linjash elektrike mbitokesore, ajrore, nentokesore, kabllorë për energji elektrike, i një fuqie dhe telekomunikacioni, nenstacione elektrike të larta e të mesme.



SELIA DHE ADRESA ELEKTRONIKE E SHOQËRISË

NENI 3

Selia e shoqërisë **"Sirio 2021" Sh.p.k.**, është në Fushë Krujë, me adresë Fushe Kruje, Durres, Lagjia "Punetori", Rr. "E Vjeter", ZK. 1664, Nr. Pasurie. 1/194+1-14, Kati i 2.

Adresa elektronike për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:
info@sirio.al

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

NENI 4

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar.

KREU 2

KAPITALI I SHOQËRISË

VLERAT DHE PAGESAT E KAPITALIT TË RREGJISTRUAR.

NENI 5

5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë **"Sirio 2021" Sh.p.k** është 1.000.000 (njemilion) lek. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme

I) Ortaku themelues **Z. Elvis GJONAJ**: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 30 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;

II) Ortaku themelues **Z. Afrim GJESTILA**: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;

II) Ortaku themelues **Z. Besim SUKTHI**: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 20 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;

5.2 Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

5.3 Kontributet në para do të paguhet plotësisht menjëherë ndërsa kontributet në natyrë do të kalojnë shoqërisë menjëherë pas rregjistrimit në QKR.

5.3. Pagesat e kontributeve në para do të kryhen në banke dhe në cdo agjensi tjetër të specializuar për të dhe të njohur në ligj.

ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

NENI 6

6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute, sipas kërkesës së administratorit.

6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.


6.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkojnë për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

TRANSFERIMI I KAPITALIT

NENI 7

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;



ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar, janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në këtë statut.

Pjesët e kapitalit themeltar, janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KËRKESA PËR TË PAGUAR KUOTAT DHE TËRHEQJA E KUOTAVE TË PAPAGUARA

NENI 8

8.1 Administratori mund ti kerkoje ortakëve të shoqërisë pjesën e kontributeve të pashlyera në lidhje me kuotat e tyre dhe në çdo ortak (pas marrjes së njoftimit prej 14 ditësh të plotë në të cilën përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës), i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me keste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mepasshëm të pronesisë së kuotave.

8.2 Zotëruesi i përbashkët të një kuote do të jetë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mesipër.

8.3 Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, personi përgjegjës për shlyerjen e kontributeve do të paguajë një interes mbi shumën e papaguar me një kamatvonesë 4 % në vit duke filluar nga data e parashikuar për pagesën.

8.4 Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, Administratori mund të njoftojë paraprakisht të paktën katërmbëdhjetë ditë të plotë personin përgjegjës për shlyerjen e kontributeve, duke i kërkuar pagesën e shumës së pashlyer së bashku me shumën e mundshme shtesë të kamatvonesës. Njoftimi duhet të përmbajë vendin ku do të kryhet pagesa dhe deklarimin në rast moszbatimi të tij. Kuotat të cilëve u referohet njoftimi do të anulohen.

8.5 Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit të njoftimit, kuota me të cilën lidhet njoftimi, mund të anulohet me vendim të administratoreve dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendet ose shumën e pagueshme në lidhje me kuotat e anuluar të papaguara deri në momentin e anulimit.

8.6 Në pajtim me dispozitat ligjore, kuotat e anuluar mund të shiten, rishpërndahen ortakëve ose të kalohen sipas afatëve dhe mënyrave që administratorët konsiderojnë të përshtatshme.

8.7 Në pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar humbet cilesinë e ortakut në lidhje me këtë kuotë por do të jetë përgjegjës ndaj shoqërisë për të gjitha kontributet që do të shlyheshin nga ky ortak ndaj shoqërisë në datën e anulimit të kuotës së bashku me kamatvonesën e llogaritur për këto kontribute përpara anulimit të kuotës.

LLOJET E KUOTAVE, TË DREJTAVE DHE KUFIZIMEVE

NENI 9

9.1 Në përputhje me dispozitat e ligjit dhe pa cenuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emërohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marre me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave të ortakëve.

CERTIFIKATAT E KUOTAVE

NENI 10

10.1 Secili ortak ka të drejtë të përfitojë një certificate për kuotën e zotëruar prej tij. Shoqëria nuk është e detyruar të leshojë me shumë se një certificate për kuotat e zotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorezimi i certificates ndaj përfaqësuesit të zotëruarve të përbashkët të kuotave.

Emrat e zoteruesve te perbashket te kuotave do te renditen ne certifikaten e kuotes. Certifikata do te gezoje cilesine e letres me vlere.

KALIMI ME KONTRATE I KUOTAVE

NENI 11

11.1. Kontrata e kalimit te kuotes behet me shkrim dhe sipas formaliteteve te percaktuara nga administratoret. Kjo kontrate do te dergohet ne seline e shoqerise.

11.2. Administratori mund te refuzoje rregjistrimin e kalimit te kuotes ne QKB ne rast se nje kuote nuk eshte shlyer plotesisht ose ne rast se Administratoret nuk jane dakort me personin te cilit i kalon kuota.

11.3. Nese Administratori refuzon te rregjistroje kalimin e kuotes, ai do te njoftoje per mospranimin personit te cilit i kalohen kuotat. Brenda nje muaji nga data ne te cilen eshte paraqitur ne shoqeri kerkesa per rregjistrimin e kalimit te kuotes.

KALIMI I KUOTAVE ME TRASHEGIMI OSE SI PASOJE E FALIMENTIT

NENI 12

12.1. Nese nje ortak vdes, trashegimtari ose trashegimtare ne rastin e bashkezoterimit te kuotave, dhe trashegimtare e tij ne rast se ky person ishte zoterues ose trashegimtar i vetem i bashkezoteruesve te kuotave, do te personat e vetem te njohur nga shoqeria si gezues se te drejtave mbi kuoten e tij, pavarsisht parashikimeve te ketij satuti, pasuria e ortakut te vdekur nuk clirohet nga pergjegjesia ne lidhje me kuoten e zoteruar nga ai vetem apo se bashku me personat e tjere.

12.2 Personi qe fiton te drejten mbi nje kuote si pasoje e vdekjes apo falimentimit te nje ortaku pas paraqitjes se provave te kerkuara nga Administratoret , mund te zgjedhe te behet zoterues I kuotes ose te kerkoje rregjistrimin e kuotes ne emer te nje personi tjetër te caktuar prej tij si perfitues I kuotes. Nese personi I mesiperm zgjedh te behet zoterues I kuotes ai kalon kuoten ne dobi te nje personi tjetër.

12.3 Personi qe fiton te drejta mbi nje kuote si pasoje e vdekjes apo falimentit te nje ortaku do te kete te drejta qe gezonte zoteruesi i kuotes duke perjashtuar te drejten e pjesemarrjes ose te votes ne cdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme deri ne momentin e rregjistrimit ne QKR.

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT THEMELTAR

NENI 13

13.1 Asambleja e pergjithshme, me shumice te kualifikuar , mund te zmadhoje kapitalin themeltar te shoqerise duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues ne shumicen e percaktuar ne vendimin perkates. Zmadhimi I kapitalit me qellim pranimin e e ortakeve te rinj ne shoqeri miratohet nga Asambleja e Pergjithshme me shumicen e kualifikuar te votave te ortakeve.

13.2 Shoqeria mund te vendos zvogelimin e kapitalit themeltare te shoqerise me vendimin e Asamblese se Pergjithshme, te marre shumicen e kualifikuar te votave.

BLERJA E KUOTAVE TE VETA


NENI 14

14.1 Shoqeria mund te bleje kuotat e veta dhe te kryeje pagesen per blerjen e tyre , jo nga fitimet e shoqerise qe do tu shperndahen ortakeve apo emerimi I kuotave te reja vetem nese shoqeria permbush kushtet per shperndarjen e fitimeve dhe Administratoret leshojne nje certificate te aftesise paguese te parashikuara nga ky nen.

14.2 Ne rast se blerja e kuotave nuk eshte ne perputhje ligjin perkates, padite mbi pergjegjesine e shoqerise mund te ngrihen ne pajtim me parashikimet legjislacionit shqiptar qe eshte ne fuqi.

KREU 3

ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE





ORGANET E SHOQËRISË NENI 15

Organet e Shoqërisë, janë si vijon:
Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
Administratori/et;
Eksperti(et) kontabel.

ASAMBLEDHJA E PËRGJITHSHME NENI 16

16.1 Asambleja e përgjithshme e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
16.2 Asambleja e përgjithshme e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
16.3 Asambleja e përgjithshme e ortakëve, është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:
a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
b) ndryshime të statutit;
c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
d) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "ç" të kësaj pike;
dh) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
ë) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
i) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.
Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave, të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
Çdo ndryshim statuti, duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.
Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

THIRJA E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME NENI 17

17.1 Administratori therret asamblenë e përgjithshme me kërkesen e ortakëve sipas nenit 84 të ligjit, do të procedojmë me thirrjen e asamblese së përgjithshme .
17.2 Mbledhja e asamblese së përgjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me poste ose poste elektronike (email) drejtuar cdo ortaku , perfshire edhe perfaqesuesin e kuotave ne zoterim te perbashket. Njoftimi duhet te kryhet te pakten ne 7 dite te plota para dates se caktuar per

mbledhjen, pervec rasteve kur njoftimi I mbledhjes se asamblese se pergjithshme eshte miratuar nga shumica e ortakeve te cilet zoterojne jo me pak se 100 % te vleres nominale te koutave. Secilit ortak se bashku me njoftimin per mbledhje I dergohet dhe numri PIN per te mundesuar pjesmarrjen dhe votimin elektronik ne mbledhje.

17.3 Mbledhjet e asamblese se pergjithshme jave te vlefshme ne rast moskryerje te paqellimshme te njoftimit apo te mos marrjes te njoftimit te mbledhjes nga persona te cilet kanë te drejte te marrin kete njoftim, ne perjashtim te rastit kur shoqeria provon se personi I ka dhene shoqerise nje adrese te pasakte.

MBLEDHJET E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME **NENI 18**

18.1 Asambleja e pergjithshme merr vendime te vlefshme vetem me arritjen e kuorumit te parashikuar nga neni 86 I ligjit. Ortaket ose perfaqesuesit e autorizuar mund te marrin pjese nepermjet mjeteve elektronike perfshire teleperformancen (conference call), audio ose audio – video ne perputhje me nenin 88 te ligjit. Ortaket qe marrin pjese me mjete komunikimi elektronik kane te drejte te votojne nepermjet numerit PIN qe u eshte derguar se bashku me njoftimin per mbledhjen e asamblese se pergjithshme

18.2 Administratori cakton kryetarin e mbledhjes si dhe nje person per te mbajtur process – verbalin e saj.

18.3 Nese administratoret nuk deshiron te caktohet si kryetar I mbledhjes ose nese asnje prej administratoreve nuk eshte I pranishem per pesembledhjet minuta duke filluar na ora e caktuar per fillimin e mbledhjes , ortaket e pranishem dhe me te drejte vote zgjedhin njerin prej tyre si kryetar te mbledhjes.

18.4 Administratori pavaresisht se nuk eshte ortak ka te drejten e pjesemarrjes si dhe te marre fjalen ne cdo mbledhje te asamblese se pergjithshme


18.5 Kryetari me pelqimin e asamblese se pergjithshme te mbledhur ne perputhje me kuorumin e caktuar me ligj mund (dhe eshte I detyruar nese kerkohet nga asambleja e pergjithshme) te shtyje mbledhjen e asamblese se pergjithshme por ne mbledhjen e dyte mund te diskutohen vetem ato ceshtje te cilat do te ishin diskutuar rregullisht nese nuk do te ishte shtyre mbledhja e mepareshme. Kur mbledhja e asamblese se pergjithshme shtyhet te pakten katermbledhjet dite njoftimi do te kryhet te pakten shtate dite te plota perpara kesaj date dhe ne te do te percaktohet vendi dhe ora e mbledhjes se shtyre dhe pershkrimi I pergjithshem I rendit te dites. Ne rast te kundert dhenia e njoftimit nuk eshte e nevojshme.

18.6 Asambleja vendos me votim te hapur me perjashtim te rastit kur perpara ose gjate deklarimit te rezultatit nuk kerkohet ne menyren e duhur nje njoftim I fshehte. Votimi I fshehte mund te kerkohet nga : a – Kryetari ose b – Nje ortak ose ortaket qe perfaqesojne te pakten 5 % te kapitalit themeltar te shoqerise .Kerkesa e bere nga nje perfaqesues I autorizuar I ortakut ka te njejten vlere me kerkesen e paraqitur nga vete ortakut .

18.7 Me perjashtim te kundershimit te nje ortakut , deklarimi I kryetarit se vendimi eshte marre ne menyre unanime ose me nje shumice te caktuar nuk eshte miratuar ose nuk eshte miratuar me nje shumice te caktuar dhe rregjistrimi perkates ne proces verbalin e mbledhjes perben prove perfundimtare te ketij fakti , pa pasur nevojte per numerimin e votave te rregjistruara pro apo kunder votimit.

18.8 Ne rast se ka kundershime per kete deklarate do te zhvillohet nje votim I fshehte ne lidhje me percaktimin e numerit te votave pro dhe kunder vendimit.

VOTAT E ORTAKEVE **NENI 19**



19.1 Ne perputhje me te drejtat ose kufizimet qe rrjedhin nga kuotat ose cdo kuote I jep ortakut (ne rastin kur eshte individ) te pranishem apo perfaqesuesit e tij te autorizuar ose ortakut (ne rastin kur eshte person juridik) I cili eshte I pranishem permes perfaqesuesit ligjor apo perfaqesuesit te autorizuar ne menyre te rregullt , te drejten e nje vote.

19.2 Asnje ortak nuk do te votoje ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme, personalisht ose nepermjet perfaqesuesit ne lidhje me kuoten e zoteruar prej tij, nese nuk ka shlyer teresisht detyrimet qe kane te bejne me kete kuote.

19.3 Cdo kundersiztim ne kohe per cilesine e nje votuesi do ti komunikohet kryetarit , vendimi I te cilit do jete perfundimtar. Te gjitha votat e pakundersiztura ne nje mbledhje ose ne mbledhje te shtyre do te jene te vlefshme.

VENDIMI ME PROKURE

NENI 20

20.1 Perfaqesuesi do te emerohet nga ortaku sipas formes se meposhtme ose ne formen qe mund te miratohet nga administratoret.

20.2 20.3 Caktimi me shkrim I perfaqesuesit ose ne nje kopje te noterizuar apo e miratuar nga administratoret depozitohet ne seline e shoqerise ose ne nje vend tjeter Brenda territorit te Republikes se Shqiperise sic percaktohet ne njoftimin per mbledhjen e asamblese se pergjithshme ose ne ftesen per te caktuar nje perfaqesuese te derguar nga shoqeria ne lidhje me mbledhjen e asamblese se pergjithshme. Akti I emerimit te perfaqesuesit duhet te depozitohet jo me vone se dyzet e tete ore perpara ores se mbledhjes ose mbledhjes se shtyre , ne te cilen duhet te votoje perfaqesuesi.

20.4 Ne rast se akti I emerimit te perfaqesuesit jepet nepermjet komunikimit elektronik te deguar ne adresen elektronike sipas percaktimeve te pikes 3 te nenit 4, te ketij statuti, ky akt duhet te merret jo me vone se 48 ore perpara ores se mbledhjes ose mbledhjes se shtyre ne te cilen duhet te votoje perfaqesuesi .

HETIMET E POSACME

NENI 21

Personi ose personat qe plotesojne kushtet per te kerkuar emerimin apo zevendesimin e e nje eksperti te fushes, te paraqesin nje kerkese te tille nepermjet depozitimit te nje deklarate noteriale ne seline e shoqerise e cila verteton se personi ose personat plotesojne kushtet per kryerjen e ketij veprimi.

KREU 4

ADMINISTRATORET

EMERIMI I ADMINISTRATOREVE

NENI 22

22.1 Asambleja e pergjithshme zgjedh nje ose me shume persona fizike si administrator te shoqerise per nje periudhe 5-vjecare. Emerimet do te jene individuale dhe sipas nje vendimi te marre me shumice te zakonshme nga asambleja e pergjithshme I cili nese miratohet sjell emerimin e personit te propozuar si administrator.


22.2 Kufizimet ne lidhje me emerimet e administratoreve parashikohet ne piken 2 te nenit 95 te **Z. Elvis GJONAJ**

22.3 **Z. Elvis GJONAJ** caktohet si administrator i shoqerise.

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

NENI 23

23.1 Politikat tregtare te shoqerise do te administrohen nga administratori i cili mund te ushtroje te gjitha kompetencat qe nuk I rezervohen asamblese se pergjithshme sipas nenit 81te Ligjit Nr



9901, datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", (i ndryshuar). Ndryshimet e statusit nga asambleja e përgjithshme dhe udhëzimet e asamblese se përgjithshme nuk do të shfuqizojnë aktet e mëparshme të administratoreve, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

23.2 Administratoret mund të delegojnë kompetencat e tyre çdo komiteti I cili përbehet nga një ose më shumë administrator. Çdo delegim kompetencash mund të kryhet në përputhje me kushtet që vendosen administratorët dhe mund të revokohet ose ndryshohet. Administratoret nuk mund të delegojnë detyrimet ligjore.

SKUALIFIKIMI DHE SHKARKIMI I ADMINISTRATOREVE

NENI 24

24.1 Detyra e administratorit perfundon në rast se:

- a) Personi nuk është me administrator sipas parashikimeve të ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të ligjit.
- b) Personi ndodhet në gjendje pa aftësi paguese .
- c) Personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore .
- d) Personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë.
- dh) Ka munguar me shumë se gjashtë muaj rradhazi pa lejen e administratoreve të tjerë në mbledhjet e administratoreve të mbajtur gjatë kësaj periudhe dhe asambleja e përgjithshme me propozimin e administratoreve vendos ta shkarkojë nga detyra.

SHPERBLIMI, PERFITIMET E TJERA DHE SHPENZIMET E ADMINISTRATOREVE

NENI 25

25.1 Administratoret shpërblehen në bazë të skemës së vendosur nga asambleja e përgjithshme në përputhje me parashikimet e nenit 97 të ligjit Nr 9901, datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", (i ndryshuar).

25.2 Asambleja e përgjithshme mund të parashikojë përfitime nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime apo forma të tjera , për çdo person I cili ka qenë por nuk është me në detyrë apo I punësuar në shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë shoqëri të kontrolluara ose për shoqëri paraardhëse të shoqërisë ekzistuese ose të filialeve të saj , ose për çdo familje të tyre (përfshirë bashkeshortin /en , ish- bashkeshortin /en) ose persona të cilët janë ose ishin në varesi të tyre dhe mund të paguajnë kontribute në fonde të caktuara për dënimin e përfitimeve të tilla.

25.3 Administratoreve mund të paguhet të gjitha shpenzimet e udhëtimit , akomodimit dhe shpenzime të tjera të lidhje me pjesëmarrjen e tyre në mbledhjen e administratoreve ose të asamblese se përgjithshme në lidhje me përmbushjen e detyrave të tyre.

MBLEDHJET E ADMINISTRATOREVE

NENI 26

26.1 Mbledhjet e administratoreve do të mbahen sipas nevojave të aktivitetit tregtar të shoqërisë.

26.2 Vendimet e mbledhjes së administratoreve merren në kuorumin e votave që mund të percaktohen nga administratorët dhe në rast se ky kuorum nuk është percaktuar si do jete ky.

26.3 Asambleja e përgjithshme cakton njerin prej administratoreve me detyrën e kryetarit të mbledhjes së administratoreve I cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Kryetari do të caktojë çdo mbledhje të administratoreve në të cilat ai është I pranishëm. Në rast se kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është I pranishëm Brenda 5 minutave nga ora e caktuar për mbledhjen administratorët e pranishëm mund të emerojnë njerin prej tyre si kryetar të mbledhjes.

26.4 Çeshtjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve . Në rast numeri të barabartë votash , vota e kryetarit do jete vendimtarja.

26.5 Te gjitha aktet e kryera nga mbledhja e administratoreve , ose nga ndonje komitet I administratoreve apo nga persona te cilet veprojne ne cilesine si administrator,pavaresisht nese behet e ditur me vone nese ka pasur ne emerimin e nje administratori ose te njerit prej tyre ka qene I skualifikuar nga nga mbledhja e kesaj detyre, ose nuk kishin te drejte te votonin do te konsiderohen te vlefshme njesoj sikur keta persona te ishin emeruar rregullisht dhe te ishin cilesuar e te vazhdonin detyren si administrator dhe te kishin te drejten te votonin ne mbledhje.

26.6 Vendimi me shkrim I nenshkruar nga te gjithë administratoret qe kane te drejte te njoftohen per mbledhjet e administratoreve ose nga komiteti I adminstratoreve do te konsiderohet si I vlefshem dhe I efektshem njelloj si te ishin miratuar ne mbledhjen e administratoreve , e mbledhur dhe zhvilluar rregullisht.

KUFIZIMET NE VOTIMET E ADMINISTRATOREVE

NENI 27.

27.1 Administratoret nuk do te lidhin mareveshje ose do te votojne ne mbledhjen e administratoreve per ceshtje ne te cilen keta anetare kane direkt ose indirekt nje interes apo detyrim material I cili mund te jete ne kundërshtim me interes e shoqerise , ne pajtim me nenin 13 te ligjit , deri ne momentin kur ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme te gjithë anetaret kane rene dakort qe :

a) Te autorizojne lidhjen e kesaj mareveshje

b) Te autorizojne kete anetar qe te votoje ne lidhje me kete ceshtje.Autorizimi mund te jete I pergjithshem ose I posacem per nje ceshtje te caktuar .Autorizimi I pergjithshem duhet te regjistrohet prane QKR.

27.2 Vota e administratorit nuk do te llogaritet ne kuorumin e pjesemarresve ne mbledhjen ne lidhje me vendimin per te cilen ky anetar nuk ka te drejte vote .Dispozitat e nenit 89 te ligjit do te zbatohen ne perjshtim te administratorit nga vendimet e marra ne ket mbledhje.

27.3 Ne rast se ne mbledhjen e administratoreve ose komitetit te administratoreve diskutohet nje ceshtje lidhur me te drejten e votes se administratorit , ceshtja mund ti drejtohet kryetarit te mbledhjes perpara perfundimit te mbledhjes , vendimi I tij I lidhur me cdo administrator te ndryshem nga ai vete do jete perfundimtare dhe I forms se prere.

PROCES VERBALET E MBLEDHJES SE ADMINISTRATOREVE

NENI 28

28.1 Administratoret kujdesen qe ne libra te posacem te mbahen proces verbalet e :

a) te gjitha takimet e kryera nga administratoret.

b) te gjitha mbledhjeve te administratoreve te posacem , mbledhjeve te administratoreve dhe komiteteve te administratoreve perfshire dhe emrat e administratoreve te pranishem ne kete mbledhje.

KREU 5

DIVIDENTET DHE KALIMI I FITIMEVE NE KAPITALIN THEMELTAR

DIVIDENTET

NENI 29

29.1 Pas plotesimit te parashikimeve te nenit te ligjit shoqeria me shumice te kualifikuar te votave te asamblese se pergjithshme mund te deklaroje shperndarjen e dividendeve ne perputhje me te prejtat perkatese te ortakeve.

29.2 Ne perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe lidhen me kuotat te gjithë dividendet deklarohen dhe paguhen ne perputhje me Shumat e paguara per kuotat per te cilat paguhet dividenti.Te gjithë dividendet pjestohen dhe paguhen ne perpjestim te drejte me shumat e paguara per kuotat, pjese ose pjeseve te periudhes per te cilen paguhet dividenti, ne rast

se kuota emetohet me kushtin e perfitimit te dividendit nga nje date e caktuar dividendi do te paguhet ne perputhje me kete kusht.

29.3 Asnje dividend ose pagese ne para qe lidhet me nje kuote nuk do te mbarte interesa ndaj shoqerise nese nuk parashikohet nga te drejtat qe lidhen me kuoten.

29.4 Cdo dividend qe nuk eshte kerkuar te paguhet Brenda 12 vjeteve nga data e maturimit , ne rast se vendoset ne shumice te kualifikuar votash nga asambleja e pergjithshme do te perfitohet nga shoqeria e cila nuk do te jete e detyruar ta paguaje ate.

KREU 6

DISPOZITA E FUNDIT

BAZA LIGJORE

NENI 31

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me kete statut dhe dispozitat përkatëse në legjislacionin në fuqi.

Përsa nuk është parasikuar në këtë statut zbatohen dispozita e ligjit Nr 9901 , date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe dispozitat e Kodit Civil Të Republikës së Shqipërisë.

MOSMARRËVESHJET

NENI 32

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin apo zbatimin e këtij statuti si edhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet Shoqërisë dhe të tretëve, do të zgjidhen në gjykatën kompetente.

ORTAKËT THEMELUES

Elvis GJONAJ

Elvis Gjonaj

Afrim GJESTILA

AFRIM GJESTILA

Besim SUKTHI

Besim Sukthi

[Signature]

ORTAKET THEMELUES

AKT THEMELIMI

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "SIRIO 2021" SH.P.K.

Sot me date 24.03.2021, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise si edhe ne Kodin Civil Republikes se Shqiperise, ne Ligjin Nr.7512 date 10.08.1991, "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit", të ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per shoqerite tregtare", i ndryshuar dhe te ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Q.K.R dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare", me vullnetin e tyre te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi ortaket: vendosen te krijojne shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar **"SIRIO2021" SH.P.K** me akt themelimi si vijon.

NENI 1

FORMULIMI

Formohet shoqeria me pergjegesia te kufizuar, me emrin **"SIRIO 2021" SH.P.K.** Shoqeria do t'i nenshtrohet Legjislacionit Shqiptar ne fuqi, ndersa deget qe mund te krijohen do t'i nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelimi dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

NENI 2

SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **"SIRIO 2021" SH.P.K** do te kete seline ne rrugen është në Fushë Krujë, me adresë Fushe Kruje, Durrës, Lagjia "Punetori", Rr. "E Vjeter", ZK. 1664, Nr. Pasurie. 1/194+1-14, Kati i 2.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te asamblese se përgjithshme të ortakëve.

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat qe vijojne: Import dhe eksport, instalim, mirembajtje, tregti me pakice dhe shumice te paisjeve kompjuterike, kancelarike, telefonike, elektronike, mekanike, te telekomunikacionit, elektrike, hidraulike etj. Sherbime informatike, kancelarike dhe telefonike. Shperndarje intemeti. Krijim dhe mirembajtje faqesh interneti. Mirembajtje rrjeti dhe serverash. Krijim dhe shpendarje programe kompjuterike. Konsulence teknike dhe riparim pajisje kompjuterike dhe elektronike. Tregtim, import dhe eksport, instalim, mirembajtje dhe tregtim i sistemeve te telefonise, sistemeve te alarmit kundra vjedhjes, sistemeve te alarmit kundra zjarrit, sistemeve te kamerave te survejimit dhe vezhgimit CCTV, sistemeve te akses-kontrollit, sisteme aparaturash mjekesore, sisteme UPS, stabilizatore, gjeneratore, radio nderlidhje, sistemeve me fiber optike, etj. Ndertim linjash elektrike mbitokesore, ajrore, nentokesore, kabllore per energjine elektrike, i nje fuqie dhe telekomunikacioni , nenstacione elektrike te larta e te mesme.

NENI 4

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar.

NENI 5

KAPITALI I SHOQERISE



Kapitali themeltar fillestar i shoqerise "Sirio 2021" Sh.p.k është 1.000.000 (njemilion) lek. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme

I) Ortaku themelues **Z. Elvis GJONAJ**: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 30 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;

II) Ortaku themelues **Z. Afrim GJESTILA**: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;

II) Ortaku themelues **Z. Besim SUKTHI**: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 20 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Kapitali është 100% nga kuotat e ortakeve themelues të shoqërisë. Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet ose të pakesohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar).

NENI 6

DREJTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, **Z. Elvis GJONAJ** i cili do të jetë përfaqësues ligjor i shoqërisë dhe administrator i saj. Me vone dhe kurdohere me miratimin e asamblese së ortakeve do të vendoset për administrator të ri të shoqërisë.

Ai është përfaqësuesi i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretet dhe ka kompetencë të plotë në drejtimin e saj. Çdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese, nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme.

NENI 6

VULA E SHOQËRISË

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme dhe me tekstin rreth saj.

NENI 11

KRIJIMI I SHOQËRISË

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri.

Ky akt themelimi, u perpilua në gjuhën shqipe, në 3 (tre) kopje identike me njëra tjetrën, dhe do të vihet në dispozicion organeve kompetente.

Një kopje e këtij akt themelimi, do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Sirio 2021" sh.p.k.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht me vullnet të lirë të ortakëve themelues.

ORTAKËT THEMELUES

Elvis GJONAJ

Elvis Gjonaj

Afrim GJESTILA

AFRIM GJESTILA

Besim SUKTHI

Besim Sukthi

[Signature]

[Signature]

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER FLORA M. MHILLI**



V2021050350022460497

**DATE 25/03/2021
NR REP 589**

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot në Tiranë, në zyrën e noterisë Tiranë, para meje noteres publike Flora MHILLI, anetare e Dhomes Kombetare te Noterise, Dega Vendore Tirane, me seli në Rr. "Teodor Keko", Tiranë, u paraqiten personalisht deklaruesit:

1. **Z. Elvis GJONAJ**, atësia Mikel, lindur më 02.06.1988 ne Rrëshen dhe banues në Rrëshen, shtetas shqiptarë, i identifikuar nepermjet letërnjoftimit (ID) me Nr. 036280430 dhe me Nr. Personal. I80602052D, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;
2. **Z. Afrim GJESTILA**, atësia Xhelal, lindur më 01.08.1974 ne Thumanë dhe banues në Thumanë, shtetas shqiptarë, i identifikuar nepermjet letërnjoftimit (ID) me Nr. 035940153 dhe me Nr. Personal. H40801014K, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;
3. **Z. Besim SUKTHI**, atësia Bajram, lindur më 03.07.1985 ne Prezë dhe banues në Budull, Kruje, shtetas shqiptarë, i identifikuar nepermjet letërnjoftimit (ID) me Nr. 035948416 dhe me Nr. Personal. I50703061G, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Palet e mesiperme me deklaruan se statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **"SIRIO 2021" sh.p.k**, date **24.03.2021** dhe akt themelimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **"SIRIO 2021" SH.P.K**, date **24.03.2021**, bashkëngjitur këtij vërtetimi janë redaktuar ne perputhje me vullnetin e tyre të lire e të plote dhe palet me deklarojne se janë dakort që ta nënshkruajnë atë para meje noteres me vullnetin e tyre të lire dhe të plote, ndërsa unë Noterja e vërtetoj nënshkrimin e tyre ne baze të Nenit 128 të Ligjit Nr. 110, date 20.12.2018 "Për Noterinë".

**NOTERE
Flora MHILLI**



